

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6557
E shtunë, 12 mars 2022
çmimi 0.40 €

Vetëm 600 zyrtarë publikë e kanë deklaruar pasurinë nga 1 marsi | **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

MINISTRJA E JASHTME E GJERMANISË VIZITOI REPUBLIKËN E KOSOVËS | **FAQE 3**

KRYEDIPLOMATJA GJERMANE: PO PUNOJMË QË KOSOVËS T'I LIBERALIZOHEN VIZAT



Kryediplomatja gjermane, Annalena Baerbock, gjatë vizitës zyrtare në Kosovë ka bërë me dije se Gjermania është duke punuar që qytetarët e Kosovës të lëvizin pa viza. "Ne po përpiqemi dhe po punojmë me tërë forcën në mënyrë që këtë çështje ta çojmë përpara së bashku", ka thënë ajo në një konferencë për medie. Ndërsa sa i përket anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, ajo ka thënë se nuk ka rrugë të shpejtë për t'u anëtarësuar në këtë organizatë. "E kemi bërë të qartë se ka perspektivë në këtë drejtim, por për këtë duhet të bëhen hapa konkretë sa i përket forcimit të demokracisë", ka thënë Baerbock

KURTI PËR AFP-në: PUTINI SYNON KONFLIKTE TË REJA, KOSOVA ËSHTË E RREZIKUAR

Kryeministri Albin Kurti, në një intervistë për AFP-në, ka thënë se presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, është duke kërkuar një konferencë të re të Jaltës. Derisa e ka quajtur Putinin despot për shkak të luftës në Ukrainë, Kurti ka thënë se presidenti rus është duke kërkuar konflikte të reja. "Prandaj, meqë ata do të synojnë edhe konflikte të

reja, Ballkani Perëndimor në përgjithësi, e posaçërisht Kosova, janë të rrezikuar. Në të kaluarën presidenti rus na përmendte një herë në muaj, tash na përmend nga disa herë në javë dhe duket qartazi se Republika e Kosovës është një halë të cilën ai e konsideron që e pengon në projektin e vet", ka thënë Kurti



AKTUALE



MARRËVESHJA PËR BURGJET PRITET TË FINALIZOHET NË MAJ, KMDLNJ ËSHTË KUNDËR | **F. 7**

ABDIXHIKU KËRKON MBËSHTETJEN E DANIMARKËS PËR LIBERALIZMIN E VIZAVE | **F. 3**

PSD-ja, AKSION PARA QEVERISË: NA KRYPËT! | **F. 6**

INAUGUROHET PARKU I ERËS "SELAC WINDPARK" NË MITROVICË | **F. 6**

EKONOMI



SHTETI NIS AKSIONIN PAS RRRITJES SË ÇMIMEVE | **F. 8**

PANIKU I REFLEKTUAR NGA KRIZA ARTIFICIALE | **F. 8**

SPORT



SONTE DERBI YLLI - TREPÇA | **F. 10**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Putini sheh “lëvizje pozitive” në bisedimet me Ukrainën

MOSKË, 11 MARS - Presidenti rus, Vladimir Putin, ka thënë të premten se ka disa “ndryshime pozitive” në bisedimet ndërmjet Rosisë dhe Ukrainës, dy javë pas nisjes së fushatës ushtarake të Moskës për pushtimin e fqinjës. “Ka disa ndryshime pozitive, negociatorët nga ana jonë më raportuan”, i ka thënë Putini homologut të tij bjellorus, Alexander Lukashenko, gjatë një takimi në Moskë.

Ai ka thënë se negociatat “tani po zhvillohen pothuajse çdo ditë”.

Negociatorët rusë dhe ukrainas kanë mbajtur disa raunde bisedimesh që kur Putini ka dërguar trupa në Ukrainë më 24 shkurt.

Bisedimet kanë çuar në hapjen e disa korridoreve

humanitare për evakuimin e civilëve nga zonat e luftimit. Të dyja palët kanë akuzuar njëra-tjetrën për bllokimin e këtyre përpjekjeve.

Putini ka premtuar se do ta mbajë të “informuar” aleatin e tij, Lukashenko, mbi procesin e negociatave.

Të premten Kremli ka thënë se konflikti në Ukrainë do të përfundojë kur Perëndimi të ndërmarrë veprime lidhur me shqetësimet e ngritura vazhdimisht nga Rusia për vrasjen e civilëve në lindje të Ukrainës dhe zgjerimin e NATO-s drejt lindjes.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, i pyetur nga gazetarët se si mund të përfundojë kriza, ka përcaktuar pozicionin e Rosisë, duke thënë se besonte që Ukraina po diskutonte për kërkesat e



Moskës me Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tjerë. “Rusia formuloi kërkesa konkrete ndaj Ukrainës për t’i zgjidhur këto çështje. Me sa kuptojmë, ato kërkesa po

diskutohen nga ukrainasit me këshilltarët e tyre, kryesisht Shtetet e Bashkuara dhe vendet e Bashkimit Evropian”, ka thënë ai.

Zyrtarët rusë nuk e përdorin

fjalën “pushtim”, duke thënë se mediet perëndimore kanë dështuar të raportojnë për atë që ata e cilësojnë si “gjenocid” ndaj njerëzve rosisht-folës në Ukrainën lindore. Perëndimi i ka hedhur poshtë vazhdimisht shqetësimet e tilla.

Presidenti Vladimir Putin ka thënë se “operacioni special ushtarak” në Ukrainë është thelbësor për ta garantuar sigurinë ruse pasi Shtetet e Bashkuara kanë zgjeruar anëtarësimin në NATO deri në kufijtë e Rosisë dhe mbështetën liderët pro-perëndimorë në Kiev. Shumë shtete perëndimore kanë vendosur sanksione të ashpra ndaj Moskës në përpjekje për ta ndaluar pushtimin e paprovokuar dhe dëmet e mëdha në civilë dhe infrastrukturë të shkaktuara që nga 24 shkurti.

BE-ja ndan edhe 500 milionë euro ndihmë ushtarake për Ukrainën

BRUKSEL, 11 MARS - Udhëheqësit e Bashkimit Evropian kanë rënë dakord të dërgojnë një tjetër ndihmë ushtarake prej 500 milionë eurosh në Ukrainë ka thënë të premten presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel.

Ky vendim vjen pak më shumë se një javë pasi blloku njoftoi për herë të parë në historinë e tij se BE-ja do ta financojë blerjen dhe shpërndarjen e armëve dhe pajisjeve në një vend jo anëtar të Bashkimit Evropian.

BE-ja muajin e kaluar ka thyer një tabu të kahershme duke rënë dakord të paguajë për dërgesat e armëve në Ukrainë



pasi presidenti rus, Vladimir Putin, ka filluar pushtimin e fqinjit të tij.

Lëvizja ishte pjesë e një shtytjeje të gjerë nga aleatët e Ukrainës për të dërguar armë

përballë lutjeve të dëshpëruara nga Kievi për më shumë mbështetje për ta ndihmuar atë t’i luftojë forcat avancuese të Kremlinit.

Zyrtarët kanë thënë se kësti i ri i parave do të shkonte për rimbursimin e vendeve të BE-së që po dërgonin në mënyrë të njëanshme armë të kërkuara nga Kievi.

Ukraina ka bërë presion që aleatët e saj të furnizojnë sisteme të mbrojtjes ajrore për të ndihmuar në parandalimin e bombardimeve ruse pasi Perëndimi kundërshtoi thirrjet për të vendosur një zonë ndalim-fluturimi.

Udhëheqësit e BE-së e kanë

përkrahur sulmin e Moskës ndaj Ukrainës si një thirrje zgjimi për bllokun 27-vendesh që të fokusohet më shumë në forcimin e mbrojtjes. Ata priten të angazhohen “për t’i rritur ndjeshëm shpenzimet e mbrojtjes” dhe për ta forcuar bashkëpunimin në projektet e mbrojtjes midis vendeve anëtare në bisedimet pranë

Siguria kolektive në Bashkimin Evropian trajtohet kryesisht nga aleanca e NATO-s e udhëhequr nga ShBA-ja, por Franca, fuqia më e madhe ushtarake e BE-së, ka qenë në krye të thirrjeve për një rol të zgjeruar për bllokun.

Stoltenbergu: Ukraina nuk duhet të bëhet luftë e NATO-s me Rusinë

BRUKSEL, 11 MARS - NATO nuk duhet të lejojë që pushtimi rus i Ukrainës të kalojë në një luftë midis aleancës dhe Moskës, ka thënë të premten shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, duke përjashtuar përsëri një zonë të ndaluar fluturimi. “Ne kemi përgjegjësinë për të parandaluar që ky konflikt të përshkallëzohet përtej kufijve të Ukrainës dhe të shndërrohet në një luftë të plotë midis Rosisë dhe NATO-s”, ka thënë ai.

ka

paralajmëruar se një zonë ndalim-fluturimi mbi Ukrainë “me shumë gjasa do të çonte në një luftë të plotë midis NATO-s dhe Rosisë”, duke shkaktuar “edhe më shumë vuajtje, edhe më shumë vdekje dhe shkatërrim”.

Stoltenbergu ka thënë se një zonë ndalim-fluturimi mbi Ukrainë do të thotë se NATO-ja duhet t’i heqë sistemet ruse të mbrojtjes ajrore jo vetëm në Ukrainë, por edhe rreth Bjellorusisë dhe Rosisë. “Kjo do të thotë se ne duhet të jemi

gati për t’i rrëzuar aeroplanët rusë, sepse një zonë ndalim-fluturimi nuk është vetëm diçka që deklarojmë se do ta vendosim”, ka thënë ai për “AFP”-në në forumin e diplomacisë në Antalia të organizuar nga Turqia.

Ai ka theksuar se trajnimi i dhjetëra mijëra trupave ukrainase nga vendet anëtare të NATO-s në vitet e fundit, si dhe furnizimi me pajisje ushtarake, kishte rezultuar “jashtëzakonisht i rëndësishëm (për forcat e Ukrainës) në luftën kundër



forcave pushtuese ruse”. “Gjëja më e rëndësishme është që presidenti Putin duhet t’i japë fund kësaj lufte të pakuptimtë”, ka thënë ai.

Më tutje, ai ka vlerësuar gjithashtu përpjekjen e Turqisë për t’i lehtësuar bisedimet të enjten midis ministrave të jashtëm të Rosisë dhe Ukrainës në Antalia. “Është e rëndësishme që aleatët të vazhdojnë të përpiqen të mbështesin, të lehtësojnë një zgjidhje politike”, ka thënë Stoltenbergu.

MINISTRJA E JASHTME E GJERMANISË VIZITOI REPUBLIKËN E KOSOVËS

Kryediplotmatja gjermane: Po punojmë që Kosovës t'i liberalizohen vizat



Kryediplotmatja gjermane, Annalena Baerbock, gjatë vizitës zyrtare në Kosovë ka bërë me dije se Gjermania është duke punuar që qytetarët e Kosovës të lëvizin pa viza. “Ne po përpiqemi dhe po punojmë me tërë forcën në mënyrë që këtë çështje ta çojmë përpara së bashku”, ka thënë ajo në një konferencë për medie. Ndërsa sa i përket anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, ajo ka thënë se nuk ka rrugë të shpejtë për t'u anëtarësuar në këtë organizatë. “E kemi bërë të qartë se ka perspektivë në këtë drejtim, por për këtë duhet të bëhen hapa konkretë sa i përket forcimit të demokracisë”, ka thënë Baerbock

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 MARS - Ministria e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, ka qëndruar për vizitë dyditore në Republikën e Kosovës. Gjatë kësaj vizite ajo është takuar me përfaqësuesit më të lartë të shtetit, presidenten Vjosa Osmani, kryeministrin Albin Kurti dhe ministrin e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla. Në ditën e parë të vizitës kryediplotmatja gjermane ka mbajtur një konferencë të përbashkët për medie me

kryeministrin Kurti. Në këtë konferencë Annalena Baerbock ka thënë se Gjermania është duke punuar për liberalizimin e vizave për Kosovën. “Sa i përket liberalizimit të vizave edhe këtë e thashë shumë qartë. Për mua nuk është në pikëpyetje se neve na duhet liberalizimi i vizave për Kosovën dhe paqen e krijojmë vetëm së bashku me njerëzit. Ne po përpiqemi dhe po punojmë me tërë forcën në mënyrë që këtë çështje ta çojmë përpara së bashku”, ka thënë ajo. Ndërsa sa i përket anëtarësimit të Kosovës në Bashkim Evropian,

kryediplotmatja gjermane ka thënë nuk ka rrugë të shpejtë për të qenë pjesë e kësaj organizate. Në këtë kontekst, ajo ka përmendur edhe luftën në Ukrainë dhe aplikimin e këtij shteti për të qenë pjesë e BE-së. “Ne këtë po e shohim në Ukrainë. Për Ukrainën dyert e Evropës janë të hapura dhe ne po përjetojmë një situatë dhe pikërisht këtu ka përpjekje të ndryshme të BE-së që t'i dalin kundër njëra-tjetrës. Prandaj e kemi bërë të qartë se ka perspektivë në këtë drejtim, por për këtë duhet të bëhen hapa konkretë sa i përket forcimit të

demokracisë. Unë e thashë edhe më herët se nuk është e lehtë për një qeveri për t'i nisur reformat në një vend pikërisht ku jeton në një demokraci ku ka mendime të ndryshme sa i përket luftimit të korrupsionit apo forcimit të ligjit. Pikërisht kjo është rruga e cila çon drejt Evropës”, ka thënë Baerbock.

Më tutje, ajo ka thënë se Gjermania është investitorja dhe donatorja më e madhe në Kosovë, duke theksuar se duan ta zgjerojnë edhe më shumë marrëdhënien e ngushtë bilaterale. Si dëshmi për këtë ajo ka përmendur njohjen e patentëshoferëve nga Gjermania. Ministria Baerbock i ka thënë kryeministrin Kurti se e ka mbështetjen e plotë të qeverisë gjermane në rrugën e reformave. “Luftimi i korrupsionit, forcimi i sundimit të ligjit, ju në këtë rrugë e kemi mbështetjen tonë të plotë dhe ne e mbështesim forcimin e

demokracisë”, është shprehur ajo.

Ndërsa në ditën e dytë të vizitës, ministria e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, ka qëndruar në komunën e Mitrovicës, ku është shoqëruar nga kryetari i kësaj komune, Bedri Hamza dhe ai i Mitrovicës së Veriut, Milan Radojeviq. Ajo ka shprehur optimizëm për rregullimin e marrëdhënieve në mes të dyja anëve të Mitrovicës. Baerbock ka thënë se shpreson që një ditë ura e Ibrit të jetë e hapur dhe të pinë kafe në jug e të hanë darkë në veri. “Shpresoj që herën tjetër të pimë kafe në jug e të hamë darkë në veri”, është shprehur kryediplotmatja gjermane. Gjatë qëndrimit në Kosovë, kryediplotmatja gjermane ka marrë pjesë edhe në ceremoninë e inaugurimit të parkut të ri të erës “Selac Windpark” në fshatrat Selac dhe Bajgorë të komunës së Mitrovicës.

Abdixhiku kërkon mbështetjen e Danimarkës për liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 11 MARS (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka pritur në takim ministrin e Drejtësisë të Mbretërisë së Danimarkës, Nick Haekkerup. Në këtë takim Abdixhiku është njoftuar në lidhje me marrëveshjen

ndërkombëtare dypalëshe për dhënie në shfrytëzim të qelive të burgut të Gjilanit për të burgosurit nga Mbretëria e Danimarkës, e cila pritet të vijë në Kuvend. Me këtë rast, Abdixhiku e ka falënderuar ministrin Haekkerup për vizitën në LDK, duke kërkuar nga Danimarka ta mbështesë

Kosovën në proceset e saj integruese, liberalizimin e vizave, anëtarësim në NATO, BE dhe në organizata të tjera ndërkombëtare. Palët janë pajtuar që ta thellojnë bashkëpunimin e që mbështetja ndaj Kosovës të vazhdojë edhe në të ardhmen.





Kurti për 'AFP'-në: Putini synon konflikte të reja, Kosova është e rrezikuar

Kryeministri Albin Kurti, në një intervistë për "AFP"-në, ka thënë se presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, është duke kërkuar një konferencë të re të Jaltës. Derisa e ka quajtur Putinin despot për shkak të luftës në Ukrainë, Kurti ka thënë se presidenti rus është duke kërkuar konflikte të reja. "Prandaj, meqë ata do të synojnë edhe konflikte të reja, Ballkani Perëndimor në përgjithësi, e posaçërisht Kosova, janë të rrezikuar. Në të kaluarën presidenti rus na përmendte një herë në muaj, tash na përmend nga disa herë në javë dhe duket qartazi se Republika e Kosovës është një halë të cilën ai e konsideron që e pengon në projektin e vet", ka thënë Kurti

PRISHTINË, 11 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka dhënë një intervistë për agjencinë franceze të lajmeve "AFP". E njëjta është transmetuar e përkthyer në gjuhën shqipe nga zyra e kryeministrit. Në këtë intervistë Kurti ka folur për rrezikun që i kanoset Kosovës nga Rusia, për marrëdhëniet me Ukrainën si dhe për çështje të tjera.

Kurti ka thënë se presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, është duke kërkuar një konferencë të re të Jaltës. "Presidenti despotik rus, Putin, është në kërkim të një konference të re të Jaltës, por konferenca e re e Jaltës nuk është e mundshme pa luftë. Andaj, edhe kishim këtë agresion ushtarak dhe invazion rus", ka thënë Kurti, duke shtuar se Kosova është e rrezikuar nga lufta në Ukrainë pasi, sipas tij, Putini është duke kërkuar konflikte të reja. "Prandaj, meqë ata do të synojnë edhe konflikte të reja, Ballkani Perëndimor në përgjithësi, e posaçërisht Kosova, janë të rrezikuar. Në të kaluarën

presidenti rus na përmendte një herë në muaj, tash na përmend nga disa herë në javë dhe duket qartazi se Republika e Kosovës është një halë të cilën ai e konsideron që e pengon në projektin e vet", është shprehur Kurti.

Z. Kryeministër, po fillojmë me krizën në Ukrainë. Agresioni mbi Ukrainën nga Rusia, ta krijon përshtypjen që e ka tronditur, e ka rrezikuar thellësisht rendin ekzistues të sigurisë në Evropë, i cili është krijuar me përmbyshjen e Murit të Berlinit. Shumë analistë thonë që bëhet fjalë për një goditje tektonike dhe pyetja jonë e parë është, a mendoni, a ka gjasa, a ka shpresë, që ky sistem të rikthehet, të rikuperohet?

Kurti: Agresioni ushtarak dhe invazioni rus ishin shokues, por jo edhe të befasishtëm. Nuk ishin të befasishtëm, meqenëse e kemi parë duke u përgatitur dhe duke ndërtuar edhe në aspektin e ligjërimit politik nga Kremli, por edhe të grumbullimit të forcave të

mëdha ushtarake me artileri të rëndë në kufijtë lindor të Ukrainës. Pamjet janë shokuese, është vështirë ta besosh çfarë po sheh, mirëpo askush nuk mund të shtiret se ka qenë i befasuar. Kjo është një luftë e paralajmëruar më herët, për shkak se hegjemonia ruse, imperializmi rus dëshironte me çdo kusht territore të reja, dëshironte zgjerim dhe përballje me Bashkimin Evropian dhe me NATO-n. Presidenti despotik rus, Putin, është në kërkim të një konference të re të Jaltës, por konferenca e re e Jaltës nuk është e mundshme pa luftë. Andaj, edhe kishim këtë agresion ushtarak dhe invazion rus. Padyshim që arkitektura e sigurisë së kontinentit evropian duhet të rimendohet, sepse nuk i kemi më kushtet e paqes pas rënies së Murit të Berlinit. Luftërat, të cilat u zhvilluan gjatë këtyre tri dekadave nëpër kontinentet e tjera, tash kanë ardhur në Evropë dhe atë në përballje me Rusinë, e cila

udhëhiqet nga një person, që është njëkohësisht edhe shumë i hidhëruar edhe shumë nostalgjik. I kishim edhe luftërat në kuadër të shpërbërjes së dhunshme të ish-Jugosllavisë, mirëpo, ajo çfarë shohim sot, është marshimi i ushtrisë ruse, njëra ndër ushtritë më të fuqishme të botës e të kohës dhe padyshim që NATO-ja do të duhej që tash ta rris mobilizimin e vet, por gjithashtu edhe të mendojë se si t'i përgjigjet Rusisë, në kushtet kur qartazi lufta hibride doli se nuk na paska qenë zëvendësim për luftën, por fazë përgatitore për të.

Është sulmuar shteti më i madh, vendi më i madh në Evropë. Madje në mesin e observuesve perëndimorë mund të dëgjohet që e konsiderojnë këtë sulm, këtë agresion edhe si sulm mbi civilizimin perëndimor. A mendoni që ky agresion dhe i gjithë impakti që e ka krijuar ky agresion, i ka bërë të pakuptimta ndarjet në Evropë, në vende të NATO-s, vende jo të NATO-s, vende të Bashkimit Evropian, vende jo të Bashkimit Evropian, domethënë të gjithë i shtrohen rrezikut të njëjtë?

Kurti: Pajtohem. Dallimet, të cilat ekzistojnë brenda Bashkimit Evropian dhe brenda Evropës si kontinent në përgjithësi, janë bërë çështje të dorës së dytë për të mos thënë çështje të dorës së tretë, karshi

invazionit rus dhe agresionit ushtarak në Ukrainë. Andaj, nëse Bashkimi Evropian dhe NATO-ja nuk e shfrytëzojnë këtë moment për të qenë të bashkuar, ashtu siç e imponon koha, por unë besoj edhe vullneti i popujve, të drejtat qytetare dhe mirëqenia në kontinentin evropian, atëherë do ta paguajmë shumë shtrenjtë me të ardhmen tonë dhe të fëmijëve tanë.

Prandaj, është e domosdoshme që të ketë një unitet të shtuar edhe institucional, ashtu siç është popullor. Unë jam i bindur që tash popujt e Evropës kurrë nuk kanë qenë më të bashkuar, veçse ky lloj bashkimi duhet ta gjejë shprehjen e vet edhe në politikë edhe në institucionet përfaqësuese.

Bashkimi Evropian duhet të jetë i bashkuar, sepse është sulmuar Ukraina, e cila paraqet me territor shtetin më të madh në kontinentin evropian. Pra, nuk ka një shtet tjetër, i cili me gjithë territorin e vet, është në kontinentin evropian, e ka më shumë se 600 mijë kilometra katrorë, siç është rasti me Ukrainën. Pra, shteti më i lindor në kontinentin evropian, është njëkohësisht edhe më i madhi me territor dhe tash ndodhet në një sulm shkatërrues, që e dëshiron territorin e Ukrainës për Rusinë, por pa ukrainasit.

Pyetja: Keni thënë që agresioni e imponon bashkimin e Evropës si

përgjigje të parë ndaj këtij sulmi mbi një vend sovran dhe të pavarur evropian. A mendoni që kanë filluar të krijohen konditat dhe të imponohen konditat nga agresioni rus, për ngritjen e rendit të ri të sigurisë kolektive, ku do të bashkohen nën të njëjtën ombrellë të gjenden të gjitha vendet evropiane, pa marrë parasysh a i takojnë apo nuk i takojnë mekanizmeve të Bashkimit Evropian dhe NATO-s? Kryeministri Kurti: Evropa dhe përcaktimi demokratik në përgjithësi ka nevojë për një koalicion, i cili është i mbrojtjes dhe i sigurisë, por jo vetëm, kundrejt Federatës Ruse. Dhe, ajo çfarë po ngjanë në Federatën Ruse, Evropa mund ta gjejë edhe në historinë e vet.

Përshtypja ime e fuqishme është se periudha nga Gorbachevi te Yeltsini paraqiste veçse versionin rus të Republikës së Vajmarit. Kishim një dekadë të Republikës së Vajmarit në Federatën Ruse dhe tash kemi një lider despotik, i cili makinerinë e vet të luftës e ka ndërsyer kundër një populli, i cili as nuk e provokoi dhe as nuk dëshiron luftë. Në këtë kontekst politik e të sigurisë, duhet të përgjigjemi me një koalicion, me ç'rast nuk do të duhej të kufizohemi tek formulat ekzistuese të organizatave ndërkombëtare, por do të duhej që të avancohen ato, e mbase edhe të krijohen të reja, sepse situata është e jashtëzakonshme.

A ka Kosova arsye që të ndjehet e rrezikuar pas agresionit rus, sidomos kur kihet parasysh ekzistimi i marrëdhënieve dhe tensioneve shumë të larta me Serbinë e cila konsiderohet si aleati kryesor i Rusisë në këtë rajon?

Kurti: Presidenti despotik rus po

e kërkon një konferencë të re të Jaltës. Për këtë është e nevojshme lufta dhe këtë e bëri, por për këtë është e nevojshme edhe zgjerimi i konfliktit edhe jashtë Ukrainës, e këtë nuk e ka bërë ende. Përshtypja ime është që Putini dëshiron që të ulet në tryezë të negociatave me presidentin amerikan Biden e jo me presidentin ukrainas Zelensky. Synimi i tij është një konferencë e re e Jaltës, Jalta 2, me ç'rast do të ndaheshin sferat e interesit dhe në këtë mënyrë Federata ruse do të synonte të kompensohej për shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik. Prandaj, meqë ata do të synojnë edhe konflikte të reja, Ballkani Perëndimor në përgjithësi, e posaçërisht Kosova janë të rrezikuar. Në të kaluarën presidenti rus na përmendte një herë në muaj, tash na përmend nga disa herë në javë dhe duket qartazi se Republika e Kosovës është një halë të cilën ai e konsideron që e pengon në projektin e vet. Dy muaj pas çlirimit të Kosovës, presidenti rus u pat bërë kryeministër i Federatës ruse, në gusht të vitit 1999, ndërkaq me rastin e dy vjetorit të ardhjes së trupave ruse në Aeroportin e Prishtinës nga Bosnja dhe Hercegovina në qershorin e vitit 1999, pra në qershorin e vitit 2001 ai pat vizituar Kosovën, për t'i vizituar trupat ruse pikërisht në Aeroportin e Prishtinës. Le të mos harrojmë që është ky president ai i cili edhe i aneksoi Osetinë Jugore dhe Abkhazinë në Gjeorgji, pikërisht në vitin kur Kosova e shpalli pavarësinë, ndërkaq një javë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës u nënshkrua marrëveshja ndërmjet Serbisë edhe Federatës Ruse për dhënien e shumicës së

aksioneve të industrisë së naftës në Serbi te Gazprom-i dhe po ashtu të basenit të gazit në Banatski Dvor në Vojvodinë, sërisht tek Gazprom-i. Nga 250 deputetë sa i ka Kuvendi i Serbisë, 151, pra më shumë se 60 për qind, janë në grupin e miqësisë Serbi - Federatë Ruse. Në Kuvendin e Kosovës janë një dyzinë deputetësh në grupe të miqësisë me shtete të ndryshme. Pra, atje mbi 60 për qind të parlamentit janë në grupin e miqësisë me Federatën Ruse. Kur kësaj ia shtojmë edhe faktin që ka ma shumë se një dekadë që Rusia është shumë aktive në Serbi, sidomos me "Qendrën Humanitare Ruse" siç e quajnë ata në Nish dhe me Sputnikun që e ka në rajon qendrën në Beograd, natyrisht që ne duhet të jemi shumë vigjilent, të kujdesshëm, por nuk do të frikësohemi asnjëherë prej tyre.

Nuk ka pas asnjë prononcim të vetëm të liderëve të lartë të Kosovës prej shpërthimit të krizës në Ukrainë, të paktën unë nuk kam parë, ku nuk apelohej për pranimin e Kosovës në NATO. A mendoni që Ballkani si zonë tradicionale e interesit të Rusisë mund të jetë targeti i radhës i Rusisë pasi të përfundojë ky në Ukrainë?

Kurti: Në rastin më të mirë mund të themi që presidenti rus është i paparashikueshëm. Realisht ai është i parashikueshëm. Ai është lider i luftës, nuk është i paqes. Ai është i interesuar që ta marrë gjithë Ukrainën, nëse s'mund ta marrë gjithë atëherë ta ndajë sikurse Bosnjën, ta shndërrojë Kievin në një Grozni apo Sarajevë të dytë dhe gjithashtu ta shpërndajë edhe gjetiu konfliktin, ku do t'i përdorë

faktorët e aktorët të cilët i kontrollon edhe në Ballkanin Perëndimor. Në këtë situatë të jashtëzakonshme ne nuk mund të sillemi në mënyrë të zakonshme. Andaj, edhe anëtarësimi në Bashkimin Evropian edhe anëtarësimi në NATO nuk mund të jenë sipas mënyrave të vjetra.

Është tejet e domosdoshme që Brukseli si kryeqytet i dyfishtë, edhe i NATO-s edhe i Bashkimit Evropian ta rimendojë një mënyrë të re për integrimin e brendshëm dhe për zgjerimin në Ballkanin Perëndimor. Ballkani Perëndimor dhe Kosova në zemër të këtij Ballkani Perëndimor është pjesë e kontinentit evropian. Me rastin e integritimit në BE dhe në NATO, kufiri i jashtëm i këtyre dy organizmave më të rëndësishëm të paqes që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, kufiri i jashtëm zvogëlohet për rreth 3 mijë kilometra, që do të thotë edhe për sigurinë është shumë mirë.

Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor ende të paintegruara në Bashkimin Evropian për nga popullsia janë përafërsisht sa Holanda, e për nga bruto produkti vendor i kombinuar janë përafërsisht sa Sllovakia. Rrjedhimisht nuk është barrë e madhe për Bashkimin Evropian integrimi i përsheptuar i rajonit tonë.

Do të thotë mendoni që emergjenca e situatës e imponon edhe emergjencën në procedurë të pranimit, zgjerimit të NATO-s dhe Bashkimit Evropian?

Kurti: Metodat e vjetra të zgjerimit të NATO-s dhe të Bashkimit Evropian mund të kenë kosto shumë të lartë pas

agresionit ushtarak dhe invazionit rus në Ukrainë, i cili unë besoj që synon të mos ngelet vetëm në Ukrainë.

Dhe në fund Kosova dhe Ukraina nuk kanë marrëdhënie diplomatike. Ukraina nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, por përkrahja e deritanishme e Kosovës për Ukrainën, politike, morale, financiare me këto kushtet modeste të Kosovës, e ka bërë Kosovën, të krijohet përshtypja, lidere në rajon në përkrahjen e Ukrainës. Nga buron ky solidarizim me një vend që s'ka njohur Kosovën?

Kurti: Tek lufta mbrojtëse dhe çlirimtare e popullit të Ukrainës, ne gjejmë shumë ngjashmëri me situatën tonë para një çerek shekulli, kur një fqinj shumë më i madh verior dëshiron të të okupojë, të të shtypë, të të shfrytëzojë, të të diskriminojë, të krijojë aparteid dhe gjithashtu provon edhe gjenocidin, i cili në Kosovë u nis, por u ndalua nga intervenimi i NATO-s, që të mos kishim shfarosje të shqiptarëve në vendin tonë. Pra, ne kishim në njërin anë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e cila e nisi rezistencën dhe luftën për çlirim e për liri dhe kjo e ndërgjegjësoi opinionin publik ndërkombëtar, diplomacinë botërore për të na mbështetur. Askush sikurse populli i Kosovës nuk e sheh ngjashmërinë e asaj çfarë na ka ndodhur në jetën tonë, jo në librat e historisë, në jetën tonë, me kontekstin aktual në Ukrainë, ku lufta mbrojtëse dhe çlirimtare te popullit të Ukrainës, po gjen një solidaritet dhe admirim të jashtëzakonshëm në botën perëndimore demokratike, sikurse tek ne në vitet 1998 dhe 1999.

Mbahet takimi i tetë i Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë

STRASBURG, 11 MARS (ER) - Në Parlamentin Evropian është zhvilluar takimi i tetë i Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE - Kosovë. Ky takim është zhvilluar në dy sesione të ndara, në të cilat janë diskutuar tema të rëndësishme për të ardhmen evropiane të Kosovës si dhe për thellimin e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Në sesionin e parë të KPSA-së, i cili është mbajtur më 9 mars, fillimisht është diskutuar mbi marrëdhëniet BE - Kosovë. Në emër të Qeverisë së Kosovës ka folur zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, pasuar nga fjalimet e shefit të njësisë për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Kosovën, Vassilis Maragos dhe nga shefja e Divizionit për Ballkanin Perëndimor, në emër të Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm, Elsa Fenet.

Në pjesën e dytë të këtij sesioni është diskutuar mbi përcaktimin e arritur një vit pas zgjedhjeve në Kosovë, në reformat që lidhen me integrimin në BE, duke përfshirë situatën e komuniteteve pakicë. Mbi këtë temë, nga Kuvendi i Kosovës të pranishmëve i është adresuar deputetja Mimoza Kusari-Lila, njëherësh bashkëkryesuese e Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim, si dhe deputetët Enis Kervan dhe Pal Lekaj. Pjesa e tretë e këtij sesioni ka pasur në fokus temën e dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit dhe rrugën përpara. Në kuadër të këtij diskutimi, deputetët Avdullah Hoti dhe Haki Abazi nëpërmjet fjalimeve të tyre kanë sqaruar pozicionin e Kosovës në këtë dialog, të arriturat dhe sfidat përgjatë këtij procesi. Ndërsa më 10 mars ka vazhduar sesioni i dytë i këtij takimi ndërparlamentar, nën kryesimin e bashkëkryesueses së



këtij komisioni, Mimoza Kusari-Lila, e cila në hapje të takimit ka adresuar situatën në Ukrainë dhe ka kërkuar të mbahet një minutë heshtje për viktimat e agresionit rus. Sesioni i dytë ka pasur për fokus krizën energjetike dhe efektin në rimëkëmbjen paspandemike, presidencën pranceze, politikën e zgjerimit dhe mundësitë e Kosovës, Vitin Evropian të Rinisë 2022 dhe konferencën mbi të

ardhmen e Evropës. Ky sesion ka filluar me fjalimin e deputetit Armend Muja, i cili ka shtjelluar çështjen e krizës energjetike, së bashku me deputetin Elmi Reçica, njëherësh zëvendëskryesues i delegacionit të Kuvendit të Kosovës. Kurse deputetët Ariana Musliu-Shoshi dhe Fitore Pacolli-Dalipi kanë diskutuar mbi presidencën franceze dhe përfitimet e mundshme të Kosovës nga ky

kryesim. Ndërsa deputetët Driton Hyseni dhe Armend Zëmaj kanë përfunduar diskutimin duke iu adresuar Komisionit të lidhje me Vitin Evropian të Rinisë 2022 dhe Konferencën mbi të Ardhmen e Evropës. Ky takim është mbyllur me votimin e deklaratës së përbashkët në mes të Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës.

Vazhdon rënia e numrit të rasteve me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 11 MARS (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit ka vdekur një person nga Covidi dhe janë raportuar 74 raste të reja me koronavirus. Po kjo ministri ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë dhënë 356 doza të vaksinës kundër

Covidit. “Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 817 199 doza të vaksinës. Deri më sot 818 072 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 98 500 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19. Nga 1 021

testime, 47 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar 1 rast i vdekjes. Sot janë shëruar 61 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 222 892. Në total numri i rasteve aktive është 797”, ka njoftuar MSh-ja.



Inaugurohet parku i erës ‘Selac Windpark’ në Mitrovicë



MITROVICË, 11 MARS (ER) - Është inauguruar të premten parku i erës “Selac Windpark” në fshatrat e Mitrovicës, Selac dhe Bajgorë. Inaugurimi i këtij projekti është vlerësuar investim strategjik. Të pranishëm në ceremoninë inauguruese ishin kryeministri Albin Kurti dhe ministrja e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock. Me këtë rast, Kurti ka thënë se me këtë investim Kosova ndërmerr hapin e parë të madh drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme dhe të larmishme të furnizimit me energji të rinovueshme. “Agjenda e Gjelbër është një nga prioritetet e qeverisë

sonë jo vetëm sepse ajo përfshinë një aspekt të rëndësishëm të procesit tonë të integritimit në BE, por veçanërisht sepse ne kemi nevojë të heqim gradualisht qymyrin duke ruajtur pavarësinë tonë energjetike”, ka thënë kryeministri Kurti.

Tëksa i ka përmendur aspektet pse është i rëndësishëm ky investim, i cili do të mbulojë 10 për qind të kapacitetit të instaluar të vendit tonë, do t’i ulë emetimet e CO2 dhe, po ashtu, do të kontribuojë në furnizimin e përgjithshëm me energji, kryeministri Kurti ka thënë se është e qartë që në afat të gjatë

zgjidhja e vetme e qëndrueshme është investimi në burimet e ripërtërishme. “Shfrytëzoj rastin të falënderoj ‘SoWi Kosovo’ dhe z. Cornelius i cili përfaqëson kompaninë sot këtu. Falënderoj gjithashtu aksionarët e saj, Enlight Renewable Energy, Ilir Grapci dhe Christian Hammeke. Gjithashtu, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e këtij projekti të sektorit privat, i cili është më i madhi që ka financuar deri më tani në Kosovë. Zonja ministre Baerbock, vizita dhe përkushtimi juaj për zhvillimin e Kosovës vlerësohet shumë”, ka thënë Kurti.



PSD-ja, aksion te qeveria: Na krypët!

PRISHTINË, 11 MARS (ER) - Aktivistë të Partisë Socialdemokrate (PSD) kanë mbajtur një aksion simbolik para objektit të Qeverisë së Kosovës, para së cilës kanë vendosur një pankartë me mbishkrimin “Na krypët”. Në këtë aksion aktivistët kanë sjellë disa qese me kripë gatimi para derës së zyrës së kryeministrit. “Jemi dëshmitarë

të rritjes drastike të çmimeve të pothuajse të gjitha produkteve bazike të konsumit. Por, është një produkt që nuk është shtrenjtuar ende: kripa. Ekziston një arsye pse kripës në Kosovë nuk i luan çmimi, praktikisht, objekti i qeverisë është shndërruar në fabrikë të prodhimit të saj. Kryeministri e qeveria po na krypin çdo ditë”, kanë thënë zyrtarët e PSD-së.

Haradinaj për inaugurimin e parkut të erës në Mitrovicë: Meritat e kësaj qeverie për këtë projekt janë zero



PRISHTINË, 11 MARS (ER) - Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se pjesëmarrja e kryeministrit Albin Kurti për inaugurimin e parkut të erës në Mitrovicë është një lajm fantastik, por që meritat e qeverisë Kurti për këtë projekt janë zero. “Kryetari i qeverisë sot paska marrë pjesë në inaugurimin e parkut të erës në Mitrovicë, një investim i jashtëzakonshëm i Kosovës me vendet mike, që është një lajm fantastik, sado që meritat e kësaj qeverie për këtë projekt janë zero. Sikur ky kryeministër e kjo qeveri të mos e kishin kundërshtuar projektin e termocentralit të ri me Countur Global, apo projektin e gazsjellësit amerikan Shkup - Prishtinë, sot do të mund t’u gëzoheshim

edhe dy sukseseve të jashtëzakonshme në fushën e energjisë, e nuk do t’i vuanim pasojat e mungesës së energjisë e çmimeve stratosferike”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook”. Ai ka thënë se qeveria duhet të marrë shembull nga Parku i Erës në Mitrovicë, se si nisen e kryhen punët e interesit strategjik për vendin, e pse jo t’i thoshte disa fjalë të mira edhe për qeverinë Haradinaj që kishte vizion të qartë se si zgjidhej situata elektro-energjetike në vend. “Sidoqoftë, ky është sukses i Kosovës, e cila ka nevojë urgjente t’i shtyjë edhe projektet e tjera në fushën e energjisë, që sot janë ndalur nga kryeministri Kurti”, ka shkruar Haradinaj.

Marrëveshja për burgjet pritët të finalizohet në maj, KMDLNj është kundër

PRISHTINË, 11 MARS (ER) - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se qëllimi i marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Danimarkës për të burgosurit është që të finalizohet sa më shpejt. Në një konferencë të përbashkët për medie me homologun danez, Nick Haekkerup, ajo ka thënë se planifikohet që në muajin të vjen, më së largu në fillim të majit, të finalizohet kjo marrëveshje. "Qëllimi ynë është që kjo marrëveshje të finalizohet sa më shpejt. Planifikojmë që në fillim të muajit maj, ende nuk është vendosur data se kur do të finalizohet marrëveshja dhe kur do të procedohet në kuvendet e të dyja vendeve. Synimet tona janë që sa më parë kjo marrëveshje të finalizohet. Do të bëhen edhe përmirësime dhe renovime në burgun e Gjilanit, sepse ka nevojë dhe kur kjo qendër të jetë gati, do ta njoftojmë Danimarkën, pastaj do t'i sjellë të burgosurit", ka thënë Haxhiu.

Ndërsa ministri i Drejtësisë së Danimarkës, Nick Haekkerup, ka bërë me dije se nënshkrimi i parë i marrëveshjes ka ndodhur në dhjetor të vitit të kaluar. "Në dhjetor patëm takime me ministrin e Drejtësisë. Nënshkruam letërqëllimin për ta fuqizuar bashkëpunimin në fushën e të burgosurve. Diskutimi është fokusuar në marrëveshjen e dhënies me qira të burgjeve. Diskutimet kanë qenë të frytshme", ka thënë Haekkerup, duke shtuar se me një marrëveshje të tillë shteti i tij do të jetë më i zëshëm në kërkesën që Kosovës t'i jepet liberalizimi i vizave. "Ne e kemi kontaktuar Kosovën sepse kemi raporte të gjatë të dhe kemi qenë ndër vendet e para që e kemi njohur Kosovën. Ndihe mi më rahat me Kosovën. Ishte e natyrshme ta fuqizojmë bashkëpunimin tonë. Mendoj se një marrëveshje e tillë do të na mundësojë të jemi më të zëshëm sa i përket liberalizimit të vizave për Kosovën. Është e rëndësishme ta shohim zotimin e madh të Kosovës drejt anëtarësimit në NATO dhe Bashkimin Evropian (BE)", ka thënë ai.



KMDLNj deklarohet kundër marrëveshjes me Danimarkën për burgjet

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar në lidhje me marrëveshjen për lëshimin me qira të burgut të Gjilanit për të burgosurit nga Danimarka, duke e cilësuar këtë marrëveshje të dëmshme, diskriminuese dhe shkatërruese për Shërbimin Korrektues të Kosovës. "Arsyetimi i Danimarkës është se nuk ka kapacitete vendosëse dhe mbajtëse, prandaj do ta marrë me qira Qendrën e Paraburgimit në Gjilan e që nuk është fare e vërtetë. Me 200 milionë euro danezët mund të ndërtojnë së paku 7 burgje moderne apo, si zgjidhje e përkohshme, kanë mundësi ta adaptojnë ndonjë objekt tjetër që do të shërbente si burg. Apo do të ndërtonin ndonjë burg në Holandë, Suedi, Norvegji apo Belgjikë ku standardet e trajtimit janë të njëjta dhe nuk do të kishin nevojë të zbatojnë standarde të dyfishta apo diskriminuese e që do të zbatohen në Kosovë për shkak të dallimeve të mëdha në

trajtimin e të burgosurve. Disa nga këto shtete, për shkak të numrit të vogël të burgosurve, i kanë mbyllë burgjet si, p. sh., Suedia dhe Norvegjia, e lëre më se kanë mbipopullim. Mbretëria e Danimarkës e ka gjetur mënyrën më të mirë, më të lehtë dhe më të lirë të lirohet nga të burgosurit me të cilët kanë probleme të vazhdueshme duke i transferuar në Kosovë, duke e blerë një pjesë të sovranitetit të shtetit të Kosovës, fillimisht për afatin 10-vjeçar dhe duke i shkaktuar, pa asnjë dyshim, shumë probleme në të ardhmen Shërbimit Korrektues të Kosovës i cili, duke u bërë pjesë e kësaj loje të ndyrë politike, do të detyrohet të pranojë dhe zbatojë standarde të dyfishta. Në këtë mënyrë do të diskriminohen të burgosurit kosovarë të cilët do të kenë pakrahasimisht kushte më të këqija se të dënuarit për krime të ndryshme që do të importohen nga Danimarka përmes një marrëveshje jotransparente dhe të dyshimtë, diskriminuese, raciste dhe e cila legalizon zbatimin e standardeve të dyfishta", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas KMDLNj-së, të burgosurit e trafikuar nga Danimarka do të trajtohen sipas ligjeve të Mbretërisë së Danimarkës. "Udhëheqja do të jetë nga Danimarka dhe ky burg do të jetë jashtë kontrollit të Kosovës apo njësi ekstraterritoriale për aq kohë sa është lëshuar sovraniteti me qira dhe, në praktikën e shërbimeve korrektuese, nuk ka rast të ngjashëm ku zbatohen dy ligje për ekzekutim të sanksioneve penale, brenda një shteti e që e përjashtojnë njëri-tjetrin për cilësinë e trajtimit. Trajtimi në Danimarkë është sipas standardeve më të larta ndërkombëtare, kurse trajtimi në Kosovë si kriter ka standardet minimale", është thënë në këtë reagim.

Më tutje, KMDLNj-ja ka theksuar se oficerët korrektues të Kosovës që do të shërbejnë në këtë qendër të paraburgimit do të shërbejnë si punëtorë krahu apo punëtorë sezonalë nën udhëheqjen e danezëve. "Shifra prej 200 milionë eurosh për afatin 10-vjeçar është tunduese dhe mashtruese për një vend të varfër, por dëmet që do t'i shkaktohen Shërbimit

Korrektues të Kosovës dhe vetë Kosovës do të jenë shumë më të mëdha. Po të kishte një planifikim të mirëfilltë dhe përkrahje institucionale, Shërbimi Korrektues i Kosovës për afatin 10-vjeçar do të rigjeneronte më shumë të hyra përmes aktivizimit dhe fuqizimit të njësive ekonomike. Është moribide të thuhet se me importimin e kimit nga Danimarka do të investohet në energjinë e ripërtëritshme", është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke shtuar se deputetët e Kuvendit të Kosovës që do të votojnë pro kësaj marrëveshjeje do të votojnë një marrëveshje të dëmshme, diskriminuese, raciste dhe në kundërshtim të plotë me të gjitha dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare. "Kjo marrëveshje është në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut, me Ligjin për Ekzekutim të Sanksioneve Penale dhe me Rregullat Evropiane të Burgjeve që më së mirë rregullojnë statusin dhe trajtimin e personave të privuar nga liria, duke marrë parasysh specifikat e vendeve përkatëse", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Vetëm 600 zyrtarë publikë e kanë deklaruar pasurinë nga 1 marsi



PRISHTINË, 11 MARS (ER) - Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) ka bërë me dije se në javën e dytë të deklarimit të pasurisë kërkesës i janë përgjigjur rreth 600 zyrtarë publikë. Sipas AKK-së, deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë do t'i nënshtrohen 4 mijë e 737 zyrtarë të lartë publikë. "Në javën e dytë të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë, kërkesës për deklarimin e pasurisë i janë përgjigjur rreth 600 zyrtarë

publikë, ndërsa deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë do t'i nënshtrohen rreth 4 737 zyrtarë të lartë publikë", ka njoftuar AKK-ja. Procesi i deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë ka nisur më 1 mars. Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, Yll Buleshkaj, u ka rikujtuar të gjitha subjekteve deklaruese se mosdeklarimi i rregullt i pasurisë nga zyrtarët publikë, konform obligimeve

ligjore, detyron Agjencinë Kundër Korrupsionit që të paraqesë kallëzim penal. Deklarimi i rregullt vjetor i pasurisë mund të bëhet nëpërmjet paraqitjes fizike në zyrën e AKK-së ose nëpërmjet e-mail - adresës akk.deklarimi@rks-gov.net. Formularët e deklarimit të pasurisë të dërguar nëpërmjet emailit duhet të jenë të nënshkruar dhe skanuar nga ana e subjekteve deklaruese.

Paniku i reflektuar nga kriza artificiale

PRISHTINË, 11 MARS - Ngarendja e qytetarëve për t'u furnizuar shpejt e shpejt me produktet elementare të shportës familjare dhe rritja e shpejtë e çmimeve të këtyre produkteve nga tregtarët në Kosovë, e ushqejnë njëra-tjetrën dhe reflektojnë një panik të përgjithshëm në shoqëri kanë thënë ekspertët e çështjeve ekonomike dhe sociologjike. Ata kanë thënë se reagimi i qytetarëve në një mënyrë është i kushtëzuar dhe nuk duhet gjykuar për shkak se atyre nuk u janë ofruar informacionet e duhura dhe në mënyrë të mjaftueshme lidhur me mundësitë e furnizimit të tregut, ndërkohë që tregtarët kanë shfrytëzuar momentin për rritjen artificiale të çmimeve për produktet bazike të shportës së qytetarëve. Ngritja e shpejtë e çmimeve të karburanteve, në dy ditët e fundit, nga mesatarja prej 1.37 eurosh në mbi 1.80 euro për një litër naftë, është pasuar me rritje të shpejtë të çmimeve të vajit, të miellit të grurit, të produkteve të drithërave, të qumështit dhe produkteve të tij, si dhe produkteve të tjera të konsumit të përditshëm. Për shembull, çmimi për një litër vaj të lulediellit deri më 9 mars ka qenë nga 1.50 deri në 2 euro, ndërsa në mëngjesin e 10 marsit është ngritur në 3.49 euro. Ngritjen e çmimeve të produkteve bazë e ka cilësuar si artificiale edhe kryeministri Albin Kurti, duke thënë se për momentin "çmimi i vajit ushqimor në Kosovë është më i larti në botë".

Ramosaj: Mungesa e informacionit, burim i panikut

Profesori i Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Berim Ramosaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se informacionet që marrin qytetarët e Kosovës lidhur me pushtimin e Ukrainës nga Rusia dhe sanksionet e Perëndimit ndaj Rusisë dhe Bjellorusisë kanë pasur ndikim psikologjik edhe te qytetarët në Kosovë. Çrregullimet në tregjet botërore

që ndërliken me sanksionet e Perëndimit ndaj Rusisë, aktualisht, sipas tij, janë keqpërdorur nga tregtarët për t'i rritur çmimet në mënyrë artificiale, ndërkohë që Qeveria e Kosovës nuk i ka informuar me kohë qytetarët lidhur me mundësitë dhe alternativat për furnizim të tregut të Kosovës. "Shteti duhet të punojë në këtë drejtim, që të mos e sjellë situatën e panikut te qytetarët. Pra, t'i informojë drejt, të thotë që ka mallra të mjaftueshme, nëse ka ose të thotë që ky mall nuk do të jetë në treg. Do të thotë, të jetë korrekt me opinionin. Unë jam i bindur që kur opinioni apo qytetarët i marrin informacionet e sakta, atëherë ata padyshim që nuk vrapojnë. Por, në situatat e këtilla, qytetarët padyshim që vrapojnë, mund të krijojnë edhe rezerva të panevojshme", ka thënë Ramosaj. Ai ka shtuar se në bazë të informacioneve që ka, tregtarët ende nuk kanë kontrata të reja për furnizim, të cilat do t'i impononin edhe çmimet e reja.

Megjithatë, përballë rritjes së çmimeve të produkteve elementare, siç thotë ai, reagimi i qytetarëve nuk është për t'u gjykuar, sepse një pjesë domethënëse e tyre janë buzë ekzistencës për shkak të të ardhurave të ulëta. "Në fakt, sjellja e tyre konkrete është në përputhje me gjendjen që e kanë. Ata i kanë pagat minimale të cilat nuk i lejojnë ata dhe nuk u krijojnë tolerancën që të blejnë edhe me çmime të mëdha. Madje, me çmime mbi 10 për qind, nuk e kanë atë komoditet", ka vlerësuar Ramosaj.

Krasniqi: Efekti nga kujtesa për periudhat e mëhershme

Shemsi Krasniqi, profesor i Sociologjisë në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se përshpejtimi i qytetarëve për të siguruar rezerva ushqimore është një lloj impulsi që është krijuar nga dekadat e kaluara, kur jo rrallë qytetarët janë ballafaquar me mungesën e



produkteve elementare në treg. Mungesa të tilla janë shënuar që në vitet '80 dhe '90 të shekullit të kaluar, në veçanti gjatë luftës në Kosovë, në vitet 1998 dhe 1999. Për më shumë, sipas tij, fillimi i pandemisë së koronavirusit, në marsin e vitit 2020, ishte një lloj testi që nxori në pah një reagim të tillë të qytetarëve, të cilët me panik u ishin drejtuar dyqaneve për t'u furnizuar me produktet elementare. Kjo, sipas tij, po ndodh edhe tash. "Ky panik ose kjo ngarendje me përshpejtim për krijimin e rezervave, mbase është efekt nga kujtesa për periudhat e mëhershme. Tash, sikur po harrojmë se kemi një shtet, që ka një qeveri që ka një përgjegjësi dhe ka njëfarë kontrolli. Ishte dashur të kemi më shumë besim edhe në institucione, por edhe në mundësitë e reja që janë ofruar me tregjet e reja, sepse nuk jemi më ai vendi i mbyllur që kemi qenë, por vend i hapur dhe që ka tregti me shumë vende të botës dhe ka furnizime", ka thënë Krasniqi.

Megjithatë, ai ka vlerësuar se frika e qytetarëve se do të përballen me mungesë të artikujve ose që çmimi i tyre do

të rritet edhe më tej krijon efektin edhe më negativ. "Tash tregtarët e shfrytëzojnë situatën për shkak se kërkesa është e madhe dhe i rritin çmimet, si dhe përfitojnë nga kjo situatë. Mendoj se ky është çrregullim i brendshëm që është duke ndodhur dhe do të duhej të ketë kujdes më të madh në përgjithësi, por edhe kontroll më të madh nga ana e shtetit, në mënyrë që të mos ndodhin çrregullimet e brendshme të tregut", ka thënë Krasniqi.

Por, profesor Ramosaj ka vlerësuar se institucionet shtetërore kanë dështuar t'i mbikëqyrin parregullsitë eventuale me çmime në treg dhe t'i parandalojnë ato. Për më shumë, sipas tij, deri më tash Kosova nuk ka arritur as të grumbullojë dhe të ruajë rezerva shtetërore të mallrave dhe produkteve bazike. Siç thotë ai, ndonëse Kosova ka nxjerrë ligje për funksionimin e deponimeve të rezervave, ato ende nuk janë aplikuar. Madje, sipas tij, nuk ekziston as minimumi i organizimit në këtë drejtim. Ajo çfarë i mbetet të bëjë Qeverisë së Kosovës, siç ka thënë ai, është rishikimi i politikës së taksave, ndërkaq në

qoftë se trendi i rritjes së çmimeve ka karakter afatgjatë, atëherë ekzekutivi duhet të mendojë për rritjen e pagave. "Në qoftë se shihet që është një fenomen afatshkurtër, pa dyshim ndërhyrjet duhet të jenë në politikën e taksave dhe të largohen akcizat ose barrierat e tjera të ndryshme me qëllim që të paktën ato çmime që taten nga shteti, të jenë më të ulëta", ka vlerësuar Ramosaj.

Ramosaj ka thënë se për shumicën e produkteve elementare, përfshirë edhe drithërat dhe vajrat për ushqim, mund të ketë lëvizje çmimesh edhe për disa kohë, por nuk do të ketë mungesë të tyre në tregun vendor. Luhatjet e çmimeve, sipas tij, do të vazhdojnë edhe për naftën dhe derivatet e saj, në qoftë se shteti nuk i heq ose ul barrierat tarifore, sikurse Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) dhe akciza. Por, ai konsideron se produkti që pritet të mungojë mund të jetë energjia elektrike për shkak të varësisë së Kosovës nga importi i një sasive të saj. Ai pret se mund të ketë reduktime në furnizimin e qytetarëve me energji elektrike.

Shteti në aksion pas rritjes së çmimeve

PRISHTINË, 11 MARS (ER) - Pas rritjes të çmimeve, sidomos të vajit, Inspektorati i Tregut dhe Policia e Kosovës kanë dalë në aksion. Gjatë këtij aksioni janë mbyllur dy depo të operatorëve ekonomikë. "Gjatë aksionit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), konkretisht Inspektorati i Tregut, në bashkëpunim me Drejtorinë

për Hetimin e Krimeve Ekonomike të Policisë së Kosovës, janë mbyllur përkohësisht dy depo të operatorëve ekonomikë (në Fushë-Kosovë dhe Graçanicë)", ka njoftuar MINT-i.

Edhe inspektoratet komunale kanë dalë në terren pas rritjes së çmimeve. Në disa komuna janë konfiskuar mallra të paregjistruara dhe janë

shqiptuar gjoba. Në Mitrovicë janë konfiskuar 3 500 litra vaj, ndërsa në Rahovec mbi 4 600 litra për shkak të mungesës së dokumentacionit. Kurse inspektorët në Skenderaj i kanë shqiptuar gjobë prej një mijë eurosh një marketi i cili dyshohet se ka abuzuar me çmime. Të enjten një litër vaj në Kosovë është shitur deri 3.49 euro.



Raporti i agjentit sekret rus të FSB: Lufta, një katastrofë, do të përfundojmë si Hitleri



Nga Ferruccio MICHELIN
"Formiche.net"

Një analist i FSB-së, shërbimit sekret rus, shkruan në një raport mbi dyshimet e tij për pushtimin e Ukrainës të urdhëruar nga presidenti Vladimir Putin. Ky dokument është shfaqja e parë e kritikës nga brenda, duke dëshmuar më tej se Rusia nuk është një regjim monolit, dhe se aty ekzistojnë në fakt pozicione komplekse, si dhe një ndarje midis hierarkive dhe organeve të sigurisë.

Sidomos shërbimet sekrete ruse dhe Ministria e Jashtme, nuk ishin shumë të bindura për sulmin, ndryshe nga Ministria e Mbrojtjes e cila mbante pozicione më agresive. Kjo gjë ka ndodhur edhe për raste të tjera, si për shembull në Libi ku ushtria ruse ushtroi presion që të jepte mbështetje për milicët në Bengazi, ndërsa diplomatët mbajtën një linjë më dialoguese ndaj qeverisë së njohur nga OKB-ja, të cilën rebelë donin që ta rrëzonin. Raporti thekson se numri i humbjeve ruse që ka qarkulluar në media së fundi, mbi 10 mijë trupa, është i besueshëm. Po ashtu agjenti i FSB thotë se Moska "vepron në mënyrë intuitive" dhe "mbi bazën e emocioneve", me "shpresën se mund të ndodhë papritur diçka për

ne".

Në dallim nga raportimet, sipas të cilave Putin është mashtruar nga shërbimet sekrete, raporti nënvizon se FSB "u mbajt në errësirë" në lidhje me planin e luftës, ndërsa tani po "fajësohet për dështimin e pushtimit".

Agjenti thekson në raportin e tij se FSB "nuk ishte e përgatitur që të përballlej me efektet e sanksioneve gjymtuese", dhe se Moska "e ka humbur kontrollin e shumë divizioneve në Ukrainë". Pasi vë në dukje në detaje të problemeve të hasura në Ukrainë, agjenti bën një vlerësim shumë pesimist mbi ushtrinë ruse.

"Në përgjithësi Rusia nuk ka asnjë rrugëdalje nga kjo luftë që ka nisur. Ajo nuk ka opsione për një fitore të mundshme, por e presin vetëm humbje. Edhe me hipotezën e një rezistenceminimale nga ukrainasit, neve do të na duheshin mbi 500.000 ushtarë, pa futur këtu furnizimet dhe punëtorët e logjistikës, që të kishim mundësi të kontrollonim Ukrainën" - thekson ai.

Përfundimi: "Do të zhytemi në një konflikt të madh ndërkombëtar ashtu si Hitleri në vitin 1939!". Kjo konsideratë është shumë e hidhur, nëse kemi parasysh pretendimin e Vladimir Putinit, të ripohuar këto ditë edhe nga ambasadori rus në Itali, Sergei Razov, se synimi kryesor

i luftës është "de-nazifikimi i Ukrainës".

Apeli është shumë domethënës: revizionizmi Putinian, e ka lartësuar rolin e Ruisë në Luftën e Dytë Botërore, duke e përshkruar vendin e tij si një fuqi që e shpëtoi botën nga nazizmi. Dhe Kremli e përdor shpesh etiketimin "nazist" kundër armiqve të tij, për të nxitur veprimin tek njerëzit e tij: "nazistët" e justifikojnë veprimin. Edhe për këtë referencë toksike në raportin kritik të FSB-së, ka lindur më shumë se sa një dyshim. Por burimi është i mirë. Dokumenti ka rënë në duart e Vladimir Osechkin, një aktivist rus i të drejtave të njeriut që drejton uebsajtin kundër korrupsionit "Gulagu.net", i cili konsiderohet zakonisht një kanal shumë i besueshëm i opozitarizmit rus.

Christo Grozev, ekspert në portalin investigativ, Bellingcat, dhe një nga më të njohurit sa i përket analizës së inteligjencës ruse, tha për "London Times" se ai ua kishte treguar raportin dy oficerëve të FSB-së, të cilët thanë se "nuk kishin dyshime se ai ishte shkruar nga një kolegu i tyre".

Këto dyshime janë më se legjitime, duke pasur parasysh rëndësinë e mundshme të pretendimeve, por edhe faktin se në të kaluarën SBU, agjencia kryesore e sigurisë dhe e

kundërzbulimit ukrainas, publikonte raporte të falsifikuara, që deklaroheshin sikur ishin shkruar nga Moska, si një formë e operacioneve psikologjike kundër Kremllinit.

Nga ana tjetër, nuk ka asnjë dyshim se në Rusi ka një kundërshtim ndaj luftës, edhe sepse filluan të qarkullojnë historitë e rekrutëve (shumë të rinj në moshë), që as nuk e dinin se do të luftonin, kur njësitë e tyre u nisën për në front. Eprorët u kishin thënë se do të merrnin pjesë në një stërvitje rutinë.

Lyudmila Narusova, 70 vjeçe, ish-gruaja e Anatoli Sobchak, kryebashkiaku i parë i zgjedhur në mënyrë demokratike në Shën Petersburg, që vdiq në rrethana misterioze në vitin 2000 kur Putin u bë president i vendit, tha për Dozhd, një televizion rus i pavarur, se ushtarët rusë që kanë vdekur në Ukrainë po "mbeten të pavarrosur, ndërsa qentë endacakë po i shqyejnë trupat e tyre, dhe se ata në disa raste as që mund të identifikohen pasi janë djegur".


16 mijë rusë janë arrestuar këto ditë, vetëm sepse guxuan të protestonin kundër luftës. Vetëm të dielën u arrestuan 4 mijë kundërshtarë të luftës së Putinit, që sipas dokumentit të analistit të FSB, nëse nuk përfundon deri në qershor, do ta gjunjëzohë ekonominë ruse (e cila

ka hyrë që tani në një krizë të madhe).

Numri më i madh i arrestimeve është regjistruar në Yekaterinburg, në rajonin e Uraleve, dhe në Novosibirsk në Siberi. Rajoni i Siberisë, tregoi edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2020 mbështetje të gjerë për kandidatët anti-putinianë, ndoshta edhe për shkak të fushatës elektorale të Alexei Navalny, liderit të opozitës ruse, i cili u helmua atje përpara se të burgosej.

"Për shkak të Putinit, emri Rusi është tani sinonim i luftës për shumë njerëz në botë. Dhe kjo nuk është e drejtë: ishte Putini dhe jo Rusia, ajo e që e sulmoi Ukrainën" - deklaroi Navalnyditët e fundit. Dhe dëgjimi i zërit të kundërshtarëve më mediatikë të sistemit të Putin në këtë moment, nuk është një shenjë pozitive për Kremllin.

Po për këtë arsye, Kremllin e ka izoluar Rusinë nga bota. Ajo po i mban qytetarët e saj larg deklaratave të caktuara. Ndërkohë Kreu i CIA-s, William Burns, ishte shumë i qartë: "Putini është ndoshta i zemëruar dhe i frustruar, sepse e kupton që nuk ka një fund-lojë të qëndrueshme politike në këtë luftë që ka nisur". Sipas inteligjencës amerikane, humbjet e pësuar nga Rusia deri më tani janë 2-4 mijë trupa, që gjithsesi është një shifër shumë e lartë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Sonte derbi Ylli - Trepça



PRISHTINË, 11 MARS - Xhiroja e 22-të e Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll do të sjellë disa ndeshje mjaft interesante, ndërsa derbi zhvillohet në mes të Golden Eagle Yllit dhe Trepçës. Skuadra therandase ndodhet në vendin e parë me 16 fitore e katër humbje, kurse mitrovicasit janë në vendin e dytë me 14 fitore e shtatë humbje. Ylli është kampion dhe lider në elitë, duke kërkuar titullin e dytë e radhazi, kurse mitrovicasit, pasi fituan Kupën, duan trofeun e dytë për këtë edicion. Në tri përballjet e zhvilluara mes tyre në këtë edicion, dy herë fitoi skuadra nga Theranda, 91:68 dhe 62:84, ndërsa 'Xehetarët' fituan me shifrat 72:69. Të shtunën Sigal Prishtina e pret Dritën, ku kryeqytetasit shihen favoritë, pasi në këtë edicion kanë 10 fitore dhe 11 humbje, ndërsa gjilanasit kanë 21 humbje, në po aq ndeshje të zhvilluara, duke qenë skuadra e vetme në elitë pa fitore. Të dielën zhvillohet derbi i rivalëve të vjetër në elitën e basketbollit në mes të Bashkimit dhe Pejës. Prizrenasit kanë nëntë fitore e 12 humbje, ndërsa pejanët kanë 12 fitore e

shtatë humbje, andaj pritet një sfidë shumë interesante, me të dyja skuadrat që duan të arrijnë synimet në këtë edicion. Përballja e fundit zhvillohet në mes të Rahovecit dhe Prizreni 16. Vreshtarët janë në formë të mirë dhe do të hyjnë vetëm për fitore. Rahovecasit kanë shtatë fitore e 13 humbje, duke u renditur në vendin e shtatë, kurse prizrenasit kanë 13 fitore e gjashtë humbje.

Përballja mes kampionit dhe fituesit të Kupës në Superligën e femrave

Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 18-të në Superligën e femrave. Sfidat kryesore zhvillohet mes Penzës, kampione e Kosovës dhe Bashkimit, që muajin e kaluar fitoi Kupën e Kosovës, ku në gjysmëfinale mundi pikërisht skuadrën pejane. Vashat pejane renditen në vendin e dytë me 13 fitore dhe katër humbje, kurse ato prizrenase janë në vendin e tretë me 12 fitore e pesë humbje. Në garat e elitës këtë edicion janë përballur tri herë, ku dy herë fitoi Penza, me shifrat 63:84 dhe 77:68,

ndërsa Bashkimi fitoi 74:70. Kastrioti që numëron 17 humbje, në po aq ndeshje, do të takohet me Trepçën, që ka pesë fitore e 12 humbje, andaj skuadra mitrovicasë shihet favorite në këtë përballje. Prishtina është skuadra pa humbje në elitë, me 17 fitore në 17 ndeshje, kurse në këtë xhiro do të përballet me Vëllaznimin, që numëron katër fitore e 13 humbje.

ART MOTION SUPERLIGA - Java 22

Të shtunën takohen:
17:00 Sigal Prishtina - Drita
19:00 Golden Eagle Ylli - Trepça
Të dielën takohen:
17:00 Bashkimi - Peja
19:00 Rahoveci - Prizreni 16

SUPERLIGA E FEMRAVE - JAVA 18

Të shtunën takohen:
13:00 Kastrioti - Trepça
13:30 Prishtina - Vëllaznimi

Të dielën takohen:
19:00 Penza - Bashkimi

SHKURT

Dalin në shitje biletat e ndeshjes Zvicër - Kosovë

Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se të premten ka nisur shitja online e biletave për tifozët e Kosovës për ndeshjen miqësore Zvicër - Kosovë e cila do të zhvillohet më 29 mars në orën 18:00. Federata Zvicëriane e Futbollit e ka vënë në dispozicion vjeggjën e internetit për të gjithë të interesuarit që duan të kenë një biletë për këtë ndeshje.

Kumbulla: Jam i lumtur te Roma

Futbollisti shqiptar Marash Kumbulla luajti për 90 minuta në ndeshjen që Roma e fitoi ndaj Vittesses (0-1). Kumbulla është vlerësuar me 6.5. Në vlerësimin e bërë shkruhet që ai ishte i sigurt në zonën e tij të prapavijës, por vuante shumë mungesën e shpejtësisë. "Jam i lumtur sepse jam duke luajtur dhe duke ndihmuar ekipin dhe kjo është ajo që dua të bëj. Jemi në një periudhë mjaft pozitive. Kemi tetë rezultate të mira radhazi dhe kjo është diçka pozitive", ka deklaruar Kumbulla.

KB Peja përforcohet me ish-basketbollistin e San Antonios

KB Peja ka kompletuar transferimin e basketbollistit Darius Washington. Amerikani ka një përvojë të madhe. Në të kaluarën ishte pjesë edhe e NBA-së, duke mbrojtur ngjyrat e San Antonio Spursit. "KB Peja njofton se ka arritur marrëveshje me lojtarin me shumë përvojë Darius Washington. Veterani nga Amerika ka një përvojë të madhe në ligat më të forta Botërore. Ai ishte pjesë e San Antonios në NBA dhe, po ashtu, e shumë ekipeve të njohura evropiane si: PAOK, Aris, Galatasaray, Roma, Turk Telekom etj. Ai ka arritur të jetë top koshashënues në Ligën Turke, EuroCup, 2 herë kampion në Çeki, MVP Final në Çeki e shumë suksese të tjera", thuhet në njoftimin e KB Peja.

Superliga e hendbollit sjell tri ndeshje interesante

Xhiroja e 20 e Superligës A e Kosovës në hendboll ofron tri ndeshje që pritet të jenë të forta. Xhiroja hapet në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Takohen Besa Famgas dhe Prishtina. Pra takohen i pari dhe i dyti në tabelë. Besa udhëheq me 38 pikë, ndërsa Prishtina është e dyta me 33. Besa Famgas ka fituar përballjet e këtij edicioni me Prishtinën, por shpresohet për një ndeshje të fortë dhe me

rivalitet. Ndeshja Besa Famgas - Prishtina është të shtunën me fillim nga ora 18:00. Nga ora 19:00, të shtunën, është takimi Kastrioti - Trepça. Trepça është e treta, ndërsa Kastrioti i pesti, por ferizajasit janë mobilizuar për stinorin pranveror dhe synojnë vend në "play off". Kastrioti ka dhënë sinjale me Prishtinën në ndeshjen e kaluar dhe ferizajasit paraqitje edhe më të

mirë presin ndaj mitrovicasve. Ndërkohë Trepça udhëton në Ferizaj me synim për fitore. Xhiroja e 20 mbyllet me takimin Vëllaznimi - Rahoveci. Kjo ndeshje luhet të dielën me fillim nga ora 18:00 dhe, po ashtu, pritet të jetë interesante dhe me rivalitet. Këtë fundjavë fillon gara edhe në Superligën B. Luhet ndeshja Llapi - Drenica, të shtunën, me fillim nga ora 19:00.



Kloppi: Sanksione ndaj Chelseat? Veprim i drejtë

LIVERPOOL, 11 MARS - Sanksionet që qeveria britanike ka ndërmarrë kundër pronarit të Chelseas, Roman Abramovich, janë kthyer në temë kryesore në ishull. Në lidhje me këtë ka folur edhe trajneri i Liverpoolit,

Jurgen Klopp. "Jam dakord me qeverinë britanike, por Tuchel dhe lojtarët nuk kanë asnjë përgjegjësi për atë që po ndodh. Vetëm një person është përgjegjës për këtë, Vladimir Putin. Vetëm ai. Në lidhje me

Abramovich nuk e di, por ajo që ka bërë qeveria britanike më duket e drejtë", u shpreh Klopp në konferencë për shtyp. Klubi londinez po përballlet me një situatë të paimagjinueshme, pasi bllokimi i asetëve të

pronarit Roman Abramovich mund ta çojë drejt falimentimit, gjithnjë nëse qeveria britanike nuk zbut masat kundër tyre ose, në rastin më të mirë, nëse klubi shtet sa më shpejt të jetë e mundur.



Më 1 prill hidhet shorti i Kupës së Botës

DOHA, 11 MARS - Kupa e Botës e vitit 2022 është një hap më afër, pasi të premten, më 1 prill, do të hidhet shorti zyrtar për Kupën e Botës në vendin pritës, Katar. Pesëmbëdhjetë nga 32 skuadrat tashmë janë kualifikuar duke përfshirë vendin nikoqir, Katarin. Nga Evropa, ish-kampionët, Gjermania, Spanja, Anglia dhe Franca, kanë prerë tashmë biletat e tyre për në Katar së bashku me Holandën, Kroacinë, Serbinë, Zvicrën dhe ekipin numër një në botë, Belgjikën. Dy ish-kampionë janë kualifikuar edhe nga Amerika e Jugut, Brazili dhe Argjentina, ndërsa Azia, Irani dhe Koreja e Jugut gjithashtu do të shkojnë në Katar. Kualifikimet e kombëtareve të tjera rinisin në të gjithë globin më 24 mars. FIFA njoftoi se shorti do të hidhet të premten, më 1 prill, në Qendrën e Ekspozitave dhe Konventave të Dohas (DECC). Në ceremoninë e shortit do të marrin pjesë 2 000 të ftuar specialë dhe, në fund të ngjarjes, skuadrat më të mira në botë do të jenë në gjendje ta përcaktojnë rrugën e tyre për në finalen e Kupës së Botës. Ndeshja finale e Kupës së



Botës do të zhvillohet më 18 dhjetor në stadiumin "Lusail" me kapacitet prej 80 mijë vetash. Turneu nis të hënën më 21 nëntor në stadiumin 'Al Bayt' në Al Khor, me një ndeshje ku do të luajë vendi pritës, Katar. Finalja do të luhet në stadiumin Lusail në Doha një javë para Krishtlindjeve të dielën më 18 dhjetor. 32 ekipet kombëtare që do të garojnë në 'Katar 2022' do të shpërndahen në 4 vazo me nga 8 ekipe secila. Është e rëndësishme të theksohet se në kohën kur mbahet shorti final, vetëm 30 skuadra do të kualifikohen për Kupën e Botës.

Si do të jetë shorti final i Kupës së Botës 'Katar 2022'?

Dy vendet e mbetura do të plotësohen deri më 14 qershor pasi të jenë luajtur ndeshjet "play-off" interkontinentale. Aty do të luajnë: një Kombëtare e Concacaf kundër një Kombëtare të Oqeanisë dhe një Kombëtare e Conmebol kundër një Kombëtare të Azisë. Në varësi të pozicionit të tyre në renditjen më të fundit të FIFA-s, çdo ekip i kualifikuar në Kupën e Botës "Katar 2022" do të vendoset në një vazo.

SHKURT

Pilotit rus i bllokohen llogaritë

Piloti rus i Formulës 1, Nikita Mazepin, është në listën e personave që Bashkimi Evropian do të ndërmarrë sanksione të ashpra si pasojë e luftës në Ukrainë. BE-ja do t'ia bllokojë të mirat materiale dhe financiare. Nikita Mazepin është djali i oligarkut rus Dmitri Mazepin, pronar i kompanisë Uralkali dhe të dy kanë përfunduar në listën e zezë të Bashkimit Evropian. Sipas BE-së, ata janë përfshirë në sektorë ekonomikë që furnizojnë financiarisht Federatën Ruse. Mazepin është përjashtuar së fundi nga makina amerikane Haas dhe për këtë arsye ka hedhur në gjyq ish-ekipin e tij.

Donnarumma, afër largimit nga PSG-ja

Gigio Donnarumma pritet të largohet nga PSG-ja në afatin kalimtar të verës. "La Gazzetta dello Sport" raporton se trajneri i Italisë, Roberto Mançini, e ka telefonuar Donnarumma për ta qetësuar, ndërsa Juventus është sërish i interesuar për yllin e PSG-së. Portieri italian është në qendër të vëmendjes pas një gabimi të madh kundër Real Madridit në ndeshjen e dytë të raundit të 16-të të Ligës së Kampionëve të mërkurën mbrëma. I vetmi problem që duhet për "Zonjën e Vjetër" është paga e 23-vjeçarit që është 8 milionë euro në vit në Paris.

Tucheli: Jam i lumtur që jam ende te Chelsea

Menaxheri gjerman, Thomas Tuchel, këmbëngul se është ende i lumtur te klubi anglez Chelsea. Pronarit të Chelseat, Roman Abramovich, i janë ka ngrirë pasuritë pas pushtimit rus të Ukrainës, situatë kjo e cila ka ndaluar shitjen e klubit nga ana e tij. Ky veprim synon ta ndalojë miliarderin rus të fitojë para nga shitja e Chelseat. Për këtë situatë është pyetur trajneri Tuchel, i cili nuk ka ngurruar të tregojë se është i lumtur në "Stamford Bridge". "Nuk jam i sigurt nëse jam i shqetësuar, por jam i vetëdijshëm për këtë. Situata ndryshon pothuajse çdo ditë. Jam ende i lumtur që jam këtu dhe ende i lumtur që jam menaxher i një ekipi të fortë. E di që ka shumë zhurmë përreth", ka thënë fillimisht Tuchel. "Është një ndryshim mjaft i madh nga dje në sot, por ne nuk mund të ndikojmë, nuk e kemi shkaktuar situatën. Për momentin duket se biznesi, le të themi futbollistik, është pak a shumë i mbrojtur, por le të shohim. Ndihej i privilegjuar që kam mundësinë të përfshihem në ndeshje, stërvitje dhe futboll që dua", ka shtuar trajneri gjermani.

Xavi: Sinonim fitoren, por kundërshtari luajti mirë

Barcelona nuk ka shkuar më shumë se një barazim pa gola në ndeshjen e vajtjes në 1/8-at e finaleve në Ligën e Evropës. Skuadra e Xavit është ndalur në shtëpi nga Galatasaray në një takim ku Barça ka qenë hija e vetvetes. Të mësuar me një ecuri të shkëlqyer në javët e fundit, ajo e mbrëmshme ka qenë një ndeshje për t'u harruar për Barcelonën. Edhe Xavi e ka pranuar se skuadra e tij nuk ka luajtur mirë dhe është e detyruar ta kërkojë kualifikimin në Turqi të enjten e ardhshme. "Ky nuk është rezultati më i mirë për ne, pasi kishim të tjera pritshmëri. Shpresonim të fitonim e të hidhnim një hap të sigurt, por kur nuk shënon gjithçka bëhet më e vështirë. Kishim disa mundësi, por në përgjithësi nuk jemi shfaqur si duhet. Meritë ka dhe kundërshtari", ka thënë Xavi.

Uka për herë të tretë fiton çmimin 'ylli i javës'

PRISHTINE, 11 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsoren e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, vazhdojnë ta japin çmimin "ylli i javës" për lojtarin më të mirë të xhiros. Këtë çmim për xhiros e 24-t e ka fituar futbollisti i KF Drenica, Kreshnik Uka. Për shumuesin 26-vjeçar kjo është hera e tretë në këtë edicion që e fiton këtë çmim dhe pa dyshim është ndër më të merituarit për rezultatet pozitive të ekipit kuqezi nga Skenderaj. Ai deri më tash ka realizuar 15 gola, duke u renditur i dyti në listën e golashënuesve. Uka shënoi dy gola në ndeshjen kundër Llapit në Podujevë, që u mbyll me rezultat 3-



3. Pas këtij barazimi KF Drenica mbetet në pozitën e pestë në renditje në BKT Superligë me 32

pikë. Çmimin "ylli i javës" për futbollistin e KF Drenica, Kreshnik Uka, e dha Urim Bajgora, IT në BKT.

Gjashtë trajnerët që nuk janë shkarkuar asnjëherë

Menaxhimi i një klubi futbollit nuk është një detyrë e lehtë. Futbollit është një sport shumë i orientuar drejt rezultateve për shkak të shumave të mëdha të parave të përfshira. Të jesh menaxher futbollit është me të vërtetë një punë me rrezik të lartë dhe me shpërblim të lartë, veçanërisht në

nivelin më të lartë. Menaxherët adhurohen dhe lavdërohen kur japin rezultate të mira dhe fitojnë trofe. Megjithatë, ata shpesh shkarkohen për dështimin për të dhënë rezultate pozitive, një rënie në formë, apo edhe për mosmarrëveshje me lojtarët ose hierarkinë. Ndërsa shkarkimi i

menaxherëve ka qenë pjesë e futbollit për një kohë të gjatë, norma është rritur ndjeshëm gjatë dy dekadave të fundit. Ekipet janë gjithmonë në kërkim të suksesit, qoftë ai afatshkurtër apo afatgjatë. Chelsea është një shembull kryesor i një klubi ku një menaxher nuk zgjat më shumë

se dy deri në tre vjet. Megjithatë, janë disa trajnerë që nuk janë shkarkuar asnjëherë në karrierën e tyre. Gjashtë trajnerët që nuk janë shkarkuar asnjëherë janë: Julian Nagelsmann, Didier Deschamps, Luis Enrique, Zinedine Zidane, Pep Guardiola dhe Jurgen Klopp.



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudinibardhe.com

Në bazë të vendimit të datës 10.03.2022 nga KE, sugjerimit nga Udhëheqësi i Njësisë për monitorimin e ndërmarrjeve Publike Ministria e Ekonomisë, KRU "Drini i Bardhë" Sh.A, me datën 11.03.2022 anulon këtë:

KONKURS

Pozita: Menaxher i njësisë operative, vendi Deçan (1 pozitë), dhe Zyrtar i prokurimit, vendi Pejë (1 pozitë).

Arsyetim

Anulohet konkursi për pozitën Menaxher i Njësisë Operative në Deçan dhe Zyrtar i Prokurimit në Pejë i shpallur në gazetën "Epoka e Re" i datës 01.03.2022. Konkursi anulohet për shkak të gjendjes jo të mirë financiare të kompanisë.



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudinibardhe.com

Na osnovu odluke EK od 10.03.2022, na predlog šefa Jedinice za praćenje javnih preduzeća, Ministarstvo ekonomije, RKV "Drini i Bardhe" dd, dana 11.03.2022 poništava ovo:

KONKURS

Položaj: Menadžer operativne jedinice, Dečani (1 pozicija), i Službenik za nabavke, Peći (1 pozicija).

Rasudivanje

Konkurs za poziciju menadžera operativne jedinice u Dečanima i službenika nabavke u Peći, objavljen u novinama "Epoka e Re" od 01.03.2022, se poništava. Konkurs se poništava zbog lošeg finansijskog stanja preduzeća.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Njoftim për Ankand Publik 03/2022

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar njofton të gjithë të interesuarit për pjesëmarrjen në Ankandin Publik 003-2022 i cili ishte planifikuar që të mbahet me datën 16.03.2022 se ka tërhequra nga shitja pasurinë në nr rendor 2. Seat 6 L- Ibiza viti i prodhimit 2007,dizel, ngjyre e zezë, me targa vendore, e cila është publikuar në ofertën për shitje në shtypin ditor dhe në ueb faqen e MD-se me date 10.03.2022.

Ju njoftojmë se pjesët tjera mbesin si në Ftesën paraprak për Ankandi Publik 03/2022

Ju faleminderit!

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Arbër Dakaj shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik Prishtinë, me nr. të dosjes:136889.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Datë: 12.03.2022
Prishtinë

Në bazë të nenit 8, 67 dhe 68 të Ligjit nr. 06/L- 114 për Zyrarët Publik, nenit 20 të Ligjit nr. 04/I-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe të Udhëzimit administrativ të MASHTI nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo - Arsimor dhe Aftësues |Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, shpall:

K O N K U R S
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i vendit të punës : **Drejtor në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Tereza” në Prizren**

Lloji i vendit të punës: Me afat të caktuar, me orar të plotë

Numri i pozitave: Një (1) pozitë

Kategoria funksionale: Nivel drejtues

Koeficienti: 8.4

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar (4 vite)

Qëllimi i vendit të punës: Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor.

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Menaxhimi dhe administrimi i përgjithshëm i institucionit;
- Hartimi i planit vjetor të punës dhe planit zhvillimor të institucionit arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimi efikas dhe efektiv i sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimi i kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimeve dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimit dhe vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimit dhe punëtorët tjerë në arsim;
- Mbështetja dhe mbikëqyrja e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetja dhe mbikëqyrja e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunimi me këshillin drejtues të institucionit edukativo- arsimor (KDSH);
- Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo- arsimor;
- Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislativës në fuqi;
- Ruajtja e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHTI dhe obligimet që dalin nga rregulloret e QB.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publik:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligjit.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
- Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar)
- Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimit sipas udhëzimit për licencim të mësimit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo- arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës;
- Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë.

Kandidati duhet të posedoj dhe të dëshmoj dokumentet në vijim:

- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë.
- Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje;
- Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i
- licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetim dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të UA, nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo - Arsimor dhe Aftësues |Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm;
- Dokumentacioni i aplikimit përcaktohet më lartë, dorëzohet në kopje fizike në zyrën dhe afatin e përcaktuar në konkurs publik;
- Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë të aplikoj në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla, përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë të nostrifikuar diplomat nga MASHTI.

Afati dhe mënyra e aplikimit

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data 11.04.2022 deri me 25.04.2022.

Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në uebfaqe të MASHTI (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/aplikacioni.pdf>).

Dokumentet duhet të jenë kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinali do të kërkohet me rastin e intervistimit
Informata të sakta dhe të vërteta konsiderohen vetëm ato informata që dëshmohen me dokumente (jo ato që janë të deklaruara pa dëshmi)

Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen (refuzohen).



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Datum: 12.03.2022
Priština

Na osnovu člana 8, 67 i 68 Zakona br. 06 / L-114 O javnim službenicima, član 20 Zakona br. 04 / I-032 O preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo i Administrativno uputstvo MONTI-a br. 151/2020 o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora Javnih edukativno-obrazovnih i osposbljavajućih institucija u Republici Kosovo, Procedure izbora i imenovanja, Završetak ugovora i Privremeno imenovanje, objavljuje:

K O N K U R S
ZA POPUNJAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta: **Direktor Resursnog centra za nastavu i savetovanje "Majka Tereza" u Prizren**

Vrsta radnog mesta: Na neodređeno, puno radno vreme

Broj pozicija: Jedna (1)

Funkcionalna kategorija: Upravni nivo

Koeficijent 8,4

Period imenovanja: NA određeno vreme (4 godin)

Cilj radnog mesta: Rukovođenje, menadžiranje i nadzor edukativno-obrazovne institucije

GLAVNI RADNI ZADACI

- Opšte menadžiranje i upravljanje institucije;
- Izrada godišnjeg plana rada i razvojnog plana obrazovne institucije i godišnjih izveštaja o radu;
- Efikasno i efektivno korišćenje sistema za menadžiranje informacijama u obrazovanju i poštovanje kodeksa ovog sistema, procedura osiguranja i rokova za ažuriranje potrebnih podataka u toku školske godine;
- Zadaci određeni za izbor nastavnika, ocenjivanje, disciplina u Edukativno-obrazovnoj instituciji i druga pitanja u vezi sa nastavnicima i drugim radnicima u obrazovanju;
- Podrška i nadgledanje sprovođenje kurikuluma;
- Podržavanje i nadzor nad radom aktiva i stručnih saradnika u edukativno-obrazovno institucije, kao i drugih mehanizama obrazovne institucije koji imaju ulogu u vrednovanju performanse i menadžiranje kvalitet rada institucije;
- Saraduje sa upravnim savetom edukativno-obrazovne institucije (ŠUO),
- Savet roditelja, Savet nastavnika, Savet učenika i zajednica edukativno-obrazovne institucije;
- Izveštava najmanje dva puta godišnje ispred ŠUO;
- Obezbeđuje bezbedno i podsticajno okruženje za decu / učenike, uključujući izricanje i primena disciplinskih mera prema učenicima, u skladu sa važećim zakonima;
- Očuvanje dokumenata i podataka, kao što je predviđeno od strane opštine ili Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije (MONI);
- Ostala pitanja regulisana zakonom o preduniverzitetskom obrazovanju, podzakonskim aktima odobreno od strane MONTI-a i obaveze koje proizilaze iz pravilnika RC.

Opšti zahtevi za prijem javnih službenika

- Da su državljani Republike Kosovo;
- Imaju punu sposobnost da deluje;
- Da govori jedna od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- Da je sposoban u zdravstvenom pogledu sposoban da izvrši odgovarajući zadatak;
- Da nije pravnosnažnom presudom kažnjavan za izvršeno krivično delo;
- Da nema disciplinsku meru koja je na snazi za razrešenje sa funkcije javnog službenika, razrešenog po zakonu.

Uslovi i kriterijumi za izbor kandidata:

- Imaju ima završeno fakultetsko obrazovanje nivo: Master za rukovođenju administriranje ili menadžiranje u obrazovanju (kvalifikaciju od 300 ECTS najmanje 5 godina univerzitetskog obrazovanja);
- Master obrazovni (kvalifikacija od 300 ECTS / 5 godina univerzitetskog školovanja);
- Četiri godine (kvalifikacija 240 ECTS/4 godine univerzitetskog školovanja);
- Bachelor četverogodišnji (kvalifikacija 240 ECTS / 4 godine univerzitetskog obrazovanja)
- Da ima redovnu licencu za nastavnika u skladu sa uputstvom za licenciranje nastavnika;
- Da je uspešno završio akreditovani program profesionalne kvalifikacije za rukovođenje, administraciju ili menadžiranje u obrazovanju, zasnovan na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu, odobrene od strane MONTI prema preporuka DSLN;
- Da ima radno iskustvo u edukativno-obrazovnom procesu prema smernicama navedenim u radnom katalogu;
- Pet (5) godine radnog iskustva u edukativno-obrazovnom procesu za kandidate za direktore u više srednje obrazovanje;

kandidat mora da poseduje i da dokaže sledeća dokumenta:

- Diploma o završenom fakultetu za odgovarajući nivo kvalifikacije;
- Sertifikat o uspešnom završetku program treninga za rukovođenje, administriranje ili menadžiranje u obrazovanju, zasnovano na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu,
- Kandidat/kinja koji ima završen univerzitetski program Master za rukovođenje, administriranje ili menadžiranje u obrazovanju, (u nedostatku sertifikata o završenoj obuci za rukovođenje u obrazovanju kandidat/kinja, dostavlja kao dokaz diplomu Master rukovođenja.
- Kopija identifikacionog dokumenta (ID);
- Zdravstveni karton izdat poslednja šest meseca od strane određene licencirane zdravstvene institucije kojim dokazuje njegovo/njeno zdravstveno stanje;
- Dokaz da kandidat nije pod istragom i dokaz da nije osuđivan/a za zločine, nasilje ili nedostojna dela kojima su obuhvaćena deca;
- Dokaz o radnom iskustvu u edukativno-obrazovnom procesu;
- Izjava pod zakletvom kojom se potvrđuje da u poslednje tri godine kandidat nije bio ni na jednom rukovodećem mestu u strukturama političkih partija.
- Profesionalni portfolio sa dokazima prema uputstvima u prilogu / obrascu H, br. 151/2020 o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora Javne edukativno-obrazovne i osposbljavajuće institucije u Republici Kosovo, Procedurama za izbor i imenovanje, Završetak ugovora i privremenom imenovanju.
- Dokumentacija za prijavljivanje je definisana gore, dostavlja se u štampanoj formi kancelariji u roku utvrđenom na javnom konkursu.
- Kandidat/kinja na javnom konkursu ima pravo da se aplicira u jednoj ili više škola. U takvim slučajevima priprema posebno odvojeno dokumentaciju za svaku školu u koju aplicira.
- Osobe koje su diplomirale van Kosova moraju da izvrše nostrifikaciju diplome u MONTI.

Rok i način apliciranja

30 dana od dana objavljivanja konkursa ostaje samo obaveštenje, dok konkurs ostaje otvoren 15 dana, aplikacije se podnose od 11.04.2022 do 25.04.2022 .

Popunjeni obrazac za apliciranje (dobija se na web stranici MONTI-a (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/aplikacioni.pdf>).

Dokumenti moraju biti kopije jer se ne vraćaju, dok će original biti potreban tokom intervjuja

Tačne i istinite informacije smatraju se samo one informacije koje su dokazane dokumentima (a ne oni koji su deklarirani bez dokaza)

Kandidati moraju dostaviti dokumenta Ministarstvu obrazovanj, nauke, tehnologije i inovacije.

Aplikacije dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, dok nepotpune aplikacije neće se razmatrati (biće odbijene).



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

